ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-24-8261-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **100 Ndërtim i sheshit Xhorxh Bush**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**PHANTOM SOLUTIONS SH.P.K.**
NUI	**810863375**
Adresa	**Rr. Jonuz Zejnullahu, Nr.63**
Vendi	**Prishtina**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Mustafa Sejdiu**
Adresa elektronike	**info@phantomsolutions.net**
Data e parashtrimit të ankesës	**31.08.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

100 Ndërtim i sheshit Xhorxh Bush

Data e kerkeses per rishqyrtim: 31/08/2024

Data e refuzimit te kerkeses per rishqyrtim:04/09/2024

Afat i fundit per dorezimin e ofertave: 10/09/2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Data e kerkeses per rishqyrtim: 31/08/2024

Data e refuzimit te kerkeses per rishqyrtim:04/09/2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje

Neni 45 - Rregullat e posaçme për përcaktimin e afatit kohor për pranimin e tenderëve të një kontrate publike të përfshirë nga një njoftim paraprak
Neni 28 - Specifikacionet teknike

Neni 27 - Dosja e tenderit
Neni 69 - Aftesia teknike dhe profesionale
Neni 53 - Sigurimi i informatave shtese per kandidatet dhe tenderuesit
Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kuvendi i Komunes se Prishtines ka publikuar tenderin ne fjale me date 14/08/2024, ku sipas dosjes se tenderit afati i fundit per dorezimin e tendereve eshte data 06/09/2024.

Me rastin e percaktimit te afatit te fundit per dorezimin e tendereve, AK ka vepruar ne kundershtim me Nenin 44 dhe Nenin 45 te LPP. Sipas dispozitave te Nenit 44 te LPP, ne rastet e kontratave me vlere te madhe, AK duhet qe te mbaje tenderin te hapur ne nje afat jo me pak se 40 dite.
Ndersa ne rastet kur ka njoftim paraprak, atehere tenderi duhet te jete i hapur ne nje afat jo me pak se 24 dite.
Afati i fundit i caktuar nga Autoriteti Kontraktues eshte me i shkurter se 40 dite, dhe me i shkurter edhe se 24 dite.

Ne fakt, AK nuk ka plotesuar kushtin e perdorimit te afatit te shkurtuar sipas Nenit 45 te LPP-se ku i njejti percakton:

"2. Afatet kohore të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni mund të përdoren vetëm nëse: (i) njoftimi paraprak në fjalë i përfshin të gjitha informacionet e përcaktuara në formularin standard të miratuar nga KRPP dhe (ii) data e publikimit të njoftimit të tillë paraprak është jo më pak se dyzet (40) ditë dhe jo më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj, para publikimit të njoftimit të kontratës përkatëse."

Autoriteti Kontraktues ne njoftimin paraprak nuk ka perfshire te gjitha informacionet e percaktuara ne formularin standard te miratuar nga KRPP. Ne njoftimin paraprak te Autoritetit Kontraktues eshte njoftuar se vlera e parashikuar e projektit eshte 500,000 Euro, ndersa ka publikuar tenderin ne fjale me afat te shkurtuar me vlere te parashikuar ne mbi 18 milion Euro.

Autoriteti Kontraktues ka vazhduar qe te veproje ne kundershtim me dispozitat e LPP-se edhe ne dosjen e tenderit dhe ne percaktimin e aftesive profesionale dhe teknike.

Ne kerkesat e stafit profesional, AK ka vendosur kerkesa qe jane te panevojshme dhe rrjedhimisht diskriminuese, pasi qe disa nga te njejtat nuk kane ndonje nderlidhje me projektin ne fjale, por jane kerkesa te cilat i plotesojne vetem nje operator ekonomik i caktuar.

Per menaxherin e projektit eshte kerkuar qe te kete certifikate per mbrojtjen nga zjarri nder te tjera.
E ndersa inxhineri i radhes i ndertimtarise, drejtimi hidroteknike eshte kerkuar qe te kete certifikate per testim te tubacioneve EN805 W400, kerkese kjo qe nuk ka te beje me projektin, por aplikohet ne projektet e shtrirjes

se ujesjellesit dhe tubave me presion.
Per nje inxhinier tjeter eshte kerkuar qe te jete i certifikuar sipas ISO 9001. Ky certifikim eshte certifikate qe i leshohet kompanive per sisteme cilesore te menaxhimit, por nuk ka te beje me individet. Pyetja qe shtrohet per Autoritetin Kontraktues eshte perse pikerkisht per kete inxhinier eshte kerkuar kjo certifikate, e jo per ndonje nga inxhinieret e tjere, kur kjo certifikate nuk ka te beje asgje me kualifikimin e inxhiniereve apo aftesine e tyre inxhinierike/teknike.

Gjithashtu ne dosje te tenderit jane vendosur kerkesa si certifikate ISO 50001, ISO 3834-2. ISO 50001 eshte certifikim per menaxhimin e energjise, qe nuk ka asnje lidhshmeri te mundshme me projektin ne fjale. Gjithashtu ISO 3834-2 eshte certifikim per saldimin e metaleve, qe nuk ka asnje lidhshmeri me projektin ne fjale.

Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka kerkuar te dorezohen mostra, por nuk ka percaktuar se kur duhet dorezuar te njejtat.

Autoriteti Kontraktues ka vendosur kerkesa diskriminuese edhe ne kerkesen per makineri, duke vendosur kerkese per eskavator me krah te gjate minimum 22 meter, dhe duke mos dhene asnje sqarim as ne informatat sqaruese se pse eshte e nevojshme kjo kerkese. Eskavatoret e tille perdoren per pastrimin e lagunave apo te ngashme kur duhet germuar ne thellesi mbi 22 metra, ndersa ne projektin ne fjale nje germim i tille nuk eshte parapare askund.

Nga ajo qe u tha me larte, Autoriteti Kontraktues ka vendosur kerkesa diskriminuese dhe afate ne kundershtim me dispozitat e LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Me date 31/08/2024 ne kemi shtruar kerkese per rishqyrtim ndaj Autoritetit Kontraktues me pretendimet e shtruara me larte. Me date 04/09/2024 ne kemi pranuar vendimin e AK lidhur me kerkesen per rishqyrtim, ku sipas te njejtes, kerkesa jone eshte aprovuar si pjeserisht e bazuar. Sipas ketij vendimi i bazuar ka qene pretendimi lidhur me afatet kohore per dorezimin e ofertave, ndersa pretendimet tjera kane qene te pa bazuara.

Me pastaj, AK ka shtyer afatin per dorezimin e ofertave, por vetem deri me date 10/09/2024, duke vepruar serish ne kundershtim me dispozitat e LPP-se lidhur me afatet ligjore.

Pas dorezimit te kerkeses per rishqyrtim AK ne kundershtim me Neni 108/A te LPP-se nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit por ka vazhduar te jape sqarime shtese. Edhe ne vendimin per kerkesen per rishqyrtim AK ka dhene sqarime shtese per dosjen e tenderit, si per shembull sqarime per dorezimin e mostrave.
Me dhenien e sqarimeve shtese AK ka vepruar ne kundershtim me Nenin 53 te LPP - Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit, paragrafi 7:

7. Nëse, në një aktivitet të prokurimit që përfshin përdorimin e procedurave të hapura, të kufizuara ose konkurruese me negociata, autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose plotësuese operatorëve ekonomik, dhe afati në të cilin informatat e tilla jepen është më i shkurtë se dhjetë (10) ditë nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve, autoritetit kontraktues do ti zgjatet afati i tillë për ti dhënë operatorëve ekonomik së paku dhjetë (10) ditë nga dita në të cilën informatat përkatëse jepen për ti dorëzuar tenderët e tyre. Nëse një operator ekonomik ka dorëzuar një tender, operatorit të tillë ekonomik do ti lejohet që të dorëzojë një përmirësim për tenderin përkatës, por përmirësimi i tillë kufizohet vetëm nëndryshimet që janë të lidhura me informatat e tilla të arsyeshme sqaruese ose shtesë.

Autoriteti Kontraktues me rastin e dhenies se sqarimeve eshte dashur qe te shtyej afatin per dorezimin e ofertave per se paku 10 dite shtese.

Ne kerkojme nga OSHP qe te aprovoje ankesen tone si te bazuar, te obligoje AK qe te largoje kerkesat diskriminuese dhe te shtyej afatin per dorezimin e ofertave per minimum 30 dite, duke pasur parasysh kompleksitetin e projektit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Pamundesimi I ofertimit dhe fitimi i Kumbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*